



NDIHMJA JURIDIKE • PRAVNA POMOC
LEGAL AID

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Drejtësisë-Ministarstvo Pravde-Ministry of Justice

Agjencia për Ndhmë Juridike Falas-Agencija za Besplatnu Pravnu Pomoc

Agency for Free Legal Aid

KORNIZA AFATMESME E SHPENZIMEVE 2024-2026

Misioni

Agjencia për Ndhmë Juridike Falas është e përkushtuar të ofrojë Ndhmë Juridike Falas duke siguruar qasje të barabartë në drejtësi për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, veçanërisht për grupet e marginalizuara.

Agjencia për Ndhmë Juridike Falas qëndron e përkushtuar në shërbim të të gjithë atyre që i plotësojnë kriteret e përcaktuara me ligj për t'iu ofruar Ndhmja Juridike Falas, veçanërisht duke respektuar parimet e drejtësisë dhe sundimit të ligjit.

Situata aktuale

ANJF është institucioni më i rëndësishëm në sistemin e integruar të Ndhmës Juridike në drejtim të ofrimit të ndihmës juridike falas. Numri dhe lloj-llojshmëria e kërkesave të shfrytëzuesve të ndihmës juridike falas, tregojnë nevojën dhe rëndësinë e fuqizimit dhe qëndrueshmërisë së këtij institucioni. Ligji nr 04/L-017 për Ndhmë Juridike Falas, rregullon krijimin e një sistemi funksional për Ndhmë Juridike Falas në procedurën Civile, Penale, Administrative dhe Kundërvajtëse, nëpërmes së cilës sigurohet qasje efektive në drejtësi për qytetarët të cilët nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare. Ligji nr 04/L-017 për Ndhmë Juridike Falas, Ligji 08/L-035 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Ndhmë Juridike Falas.

ANJF është ballafaquar me sfida të konsiderueshme për arritjen e objektivave, si pasojë e mungesës së buxhetit për shtrirjen e Ndhmës Juridike Falas në tërë territorin e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 22 të Ligjit nr 04/L-017 për Ndhmë Juridike Falas, ku parashihet themelimi i Zyrove Rajonale dhe Zyrove Mobile për Ndhmë Juridike Falas, për të mbuluar tërë territorin e Republikës së Kosovës, në mënyrë që qytetarët të cilët nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare të përfitojnë shërbime të Ndhmës Juridike Falas.

Aktualisht, Ndihma Juridike Falas ofrohet nëpërmjet 7 (shtatë) ZRNJF (zyrë rajonale për ndihmë juridike falas), të cilat funksionojnë në: Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Gjiilan, Ferizaj, dhe Gjakovë dhe përmes 14 (katërmëdhjetë) ZMNJF (zyrë mobile për ndihmë juridike falas), të cilat funksionojnë në komunat në vijim: Fushë Kosovë, Drenas, Deçan, Istog, Suharekë, Dragash, Mitrovicë Veriore, Zveçan, Leposaviq, Zubin Potok, Malishevë, Graçanicë, Skenderaj dhe Kamenicë. Këto zyra financohen nga buxheti i Republikës së Kosovës.

ANJF nuk e ka përmbushur në mënyrë të plotë nenin 22 të Ligjit për Ndihmë Juridike Falas, ku për të arritur mbulueshmëri të plotë në tërë territorin e Republikës së Kosovës, parashihet hapja e zyrave mobile në të gjitha komunat e Kosovës.

Me qëllim të përmbushjes së obligimit ligjor, Agjencia për Ndihmë Juridike Falas është angazhuar dhe ka siguruar me qarkoren 2024/02 përkrahjen financiare për hapjen e 9 zyrave mobile për ndihmë juridike falas (Vushtrri, Rahovec, Hani i Elezit, Podujevë, Kaçanik- Viti, Klinë, Lipjan-Shtime).

Ndërsa, sa i përket situatës aktuale lidhur me ngritjen e cilësisë së përgjithshme të shërbimeve që ofrohen nga Agjencia për Ndihmë Juridike Falas, ANJF është përpjekur vazhdimisht që të sigurojë aftësim profesional të stafit nëpërmjet trajnimeve të cilat njëkohësisht kanë kontribuar edhe në rritjen e cilësisë së shërbimeve juridike falas dhe shërbimeve tjera administrative.

Kryesisht trajnimet profesionale për stafin e ANJF-së janë mbështetur nga donatorët, GIZ, GIZ-DIMAK, IKAP, UNHCR, OSCE, EUKO JUST dhe ANJF.

Përveç trajnimeve, menaxhmenti dhe stafi i ANJF-së e ka të rëndësishëm zhvillimin e takimeve për fuqizim operacional dhe vazhdimisht është përpjekur dhe ka arritur që të sigurojë fonde nga donatorët për zhvillimin e këtyre takimeve. Në të kaluarën, këto takime janë mbështetur financiarisht nga USAID "Programi Drejtësia Vlenë". Mirëpo, ne si institucion kemi nevojë që të sigurojme qëndrueshmërinë buxhetore për mbajtjen e këtyre takimeve, ndryshe në bazë të buxhetit të tanishëm nuk do të mund të mbahen takimet e rregullta periodike të stafit.

Bazuar në situatën aktuale në të cilën gjindemi, ANJF në vazhdimësi është ballafaquar me sfidën rreth vetëdijësimin të qytetarëve për të drejtat e tyre dhe mundësinë e realizimit të drejtave të tyre nga ANJF.

Bazuar në raportet dhe hulumtimet e realizuara nga organizatat ndërkombëtare, me theks të veçant Raporti i USAID "Harta e Drejtësisë në Komunitet në Kosovë" i publikuar në Korrik 2022 rezulton se, pothuajse gjysma e respondentëve të anketuar, del të jenë të painformuar për rolin e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas. Më saktësisht, në pyetjen se sa janë të informuar për Agjencinë e Ndihmës Juridike Falas, 46% e respondentëve kanë deklaruar se janë të informuar shumë pak, 26.4% janë pak të informuar, 11.17% arsyeshëm të informuar, 11.17% mirë të informuar dhe 5.18% shumë mirë të informuar.

Ativitetet e ndryshme që janë ndërmarrë për vetëdijësimin dhe senzibilizimin e qytetarëve, janë përkrahur kryesisht nga donatori USAID, GIZ, UNHCR, EUKO JUST, për shkak se ANJF nuk ka pasur buxhet të mjaftueshëm për realizimin e këtyre aktiviteteve.

ANJF ka zhvilluar fushatat vetëdijësuese dhe senzibilizuese, në forma të ndryshme si: shtypjen e broshurave dhe postereve me përmbajtje informuese, ndërsa me përkrahjen e donatorëve, video spote të transmetuara në TV, dokumentare të shkurta, organizim i punëtorive me institucionet relevante, organizimi i tryezave të rrumbullakta me grupet e cënueshme, fushatave vetëdijësuese, aktivitete të ndryshme informuese përmes mbajtjes së sesioneve të drejtpërdrejta me grupe të targetuara, realizimi

i videove të shkurta për problemet e shpeshta ligjore për komunitetin jo shumice, intervista televizive, reportazhe etj.

Objektivat dhe aktivitetet

Agjencia ka objektivat e saj përmes të cilave synon të përmbush obligimin e vet kushtetues për ofrimin e ndihmës juridike falas për të gjithë qytetarët të cilët kanë nevojë për ndihmë juridike falas.

Objektivat e Agjencisë për vitet 2025-2027 janë:

1. Sigurimi i shtrirjes së ndihmës juridike falas në tërë territorin e Republikës së Kosovës

Shtrirja e ndihmës juridike falas në tërë territorin e Republikës së Kosovës është parakusht për të përmbushur misionin e ANJF si i vetmi institucion përgjegjës për organizimin dhe ofrimin e ndihmës juridike falas në nivel vendi, ashtu siç e përcakton Ligji për Ndhimë Juridike Falas. Lidhur me këtë, ANJF angazhohet për shtrirjen e ndihmës juridike falas përmes zyrave mobile në 8 (tetë) komuna ku nuk ka zyra rajonale dhe zyra mobile.

Përprjekjet e ANJF-së kanë qenë të vazhdueshme në drejtim të përmbushjes së obligimit ligjor të shtrirjes së ndihmës juridike falas. Përkundër përprjekjeve të vazhdueshme, nuk është arritur shtrirja e ndihmës juridike falas në tërë teritorin e Republikës së Kosovës, dhe pa çasje të barabartë në drejtësi mbeten edhe 8 komuna të tjera me gjithsej 55,000 banorë.

Qëllimi i kësaj objektivë është sigurimi i çasjes së barabartë në drejtësi për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës dhe mbrojtja e të drejtave të tyre të cilat mund t'iu mohohen për shkak të pamjaftueshmërisë së mjeteve financiare.

Për të siguruar shtrirjen edhe në 8 komunat në të cilat nuk ofrohet ndihma juridike falas, ANJF-ja për vitin 2025 ka prioritet sigurimin e hapjes së 4 zyrave mobile, si dhe në vitin 2026 prioritet janë edhe 4 zyra tjera mobile, për të përmbushur në mënyrë të plotë obligimin e caktuar Ligjor sispas nenit 22 të Ligjit për Ndhimë Juridike Falas.

Për të përzgjedhur komunat me prioritet, ANJF si indikator matës ka marrë në konsideratë largësinë nga Zyra më e afërt Rajonale, numrin e popullsisë, madhësinë gjeografike, numrin e popullsisë që ka përfituar nga ndihma sociale dhe nëse ajo komunë ka degë të Gjykatës apo jo. Andaj në bazë të analizave tona rezultojnë këto komuna:

ANJF planifikon që objektivi i shtrirjes për vitin 2025 të jetë në komunat:

- Komunitat: Obiliq, Kllokot, Mamushë, Shtërpçë.

Për vitin 2026 ANJF planifikon të sigurojë qëndrueshmërinë e klinikës mobile dhe të ofroj ndihmë juridike në ato komuna ku ANJF nuk ka zyra rajonale dhe zyra mobile:

- Komunitat: Novobërd, Ranillug, Partesh dhe Junik.

Me shtrirjen e ndihmës juridike falas në komunat e lartëcekura për të cilat kërkohet mbështetje për hapjen e zyrave mobile, mundësohet qasja e barabartë në drejtësi edhe për qytetarët e këtyre komunave, gjë që rritë numrin e përfituesve potencial të ndihmës juridike falas, duke e rritur efikasitetin e rezultateve të ofrimit të ndihmës juridike falas.

1.1 Aktivitetet për vitin 2025-2027:

1.1.1. Zhvillimi i politikave, arsyetimi përmes kërkesave dhe avokimi në institucionet kompetente, bashkëpunimi me institucionet komunale në drejtim të mbështjetjes së ANJF-së.

1.1.2. Rifunksionalizimi i platformës online të ofrimit të ndihmës juridike falas gjate vitit 2024, përmes përditësimeve teknologjike dhe promovimit të platformës. Vlera e nevojshme për këtë aktivitet është kostoja për mirëmbajtje të platformës prej 5,000.00 €.

1.2 Aktivitetet për vitin 2025-2027

Nga praktika e deritanishme, numri i përfituesve nga viti në vit vjen duke u shtuar, ky numër ngërthen në vete edhe rritjen e nevojës për buxhet më të lartë në drejtim të pagesave të avokatëve të angazhuar. Poashtu ndikimi i fushatave vetëdijësuese dhe informimi i qytetarëve për shërbimet e ndihmës juridike falas, kërkon edhe rritjen e buxhetit për pagesën e shërbimeve të përfaqesimit dhe avokaturës. (Ligji nr 04/L-017 për Ndihmë Juridike Falas, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr 08/L-035 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit 04/L-017 për ndihmë juridike falas, dhe tejkalimi i planifikimit për shpenzime të përfaqesimit dhe avokaturës prej 20% si dhe borxhi i bartur rreth 13,000.00 €) dhe rritjes së numrit të përfituesve sipas ligjit nr 08/L-035 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 04/L-017 për Ndihmë Juridike Falas. **Vlera vjetore e kërkuar për këtë aktivitet është 20,000.00 €.**

1.3 Aktivitetet për vitin 2025-2027 sipas objektivës së parë

Me qëllim të përmbushjes së objektivës së parë, sigurimit të shtrirjes së ndihmës juridike falas në tërë territorin e Republikës së Kosovës, si dhe mirëfunksionalizimit të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas, për përmbushjen e obligimeve që rrjedhin nga Ligji nr 04/L-017 për Ndihmë Juridike Falas, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr 08/L-035, kërkojmë pozita shtesë si dhe riklasifikim të pozitave ekzistuese dhe sigurimin e buxhetit të nevojshëm për mbulimin e pagave për zyrtarët si në vijim:

Kërkesa për pozita dhe mjete shtesë për vitin 2025:

Departamenti Ligjor:

- Drejtor i Departamentit 1 (një) pozitë
- Udhëheqës divizioni 8 (tetë) pozita të reja
- Zyrtar i lartë ligjor 2 (dy) pozita të reja

Vlera e pagave për pozitat e lartëcekura është 109,100.00€.

Në vazhdim paraqesim numrin e zyrtarëve ligjor për riklasifikim si dhe mjetet shtesë të nevojshme: Zyrtar i Lartë Ligjor 28 (njëzet e tetë) riklasifikim.

Vlera e pagave për nivelizim, saktësisht diferenca për nivelizim është 25,200.00 €

2. Ngritja e vetëdijes së qytetarëve për shërbimet që ofrohen nga ANJF

Qëllimi i dytë strategjik është ngritja e vetëdijësimit të qytetarëve për punën e ANJF-së dhe kuptimin e nevojave të tyre.

Është koncept i përgjithshëm se qasja në drejtësi është komponentë fundamentale e një shoqërie demokratike. Në mënyrë që të arrihet ky standard, çdo shoqëri duhet të zhvillojë sistem adekuat të informimit, që promovon të drejtat për qasje në drejtësi. Po ashtu, është i nevojshëm një vlerësim i qëndrueshëm për identifikimin e nevojave ligjore të qytetarëve dhe shkalla e masës së përmbushjes së nevojave nga autoritetet përkatëse si përgjigje drejt këtyre nevojave. Për të plotësuar këto mekanizma

ANJF është e përkushtuar, të punojë në këtë drejtim, duke ndërmarrë hapat e përkrahur në qëllimin strategjik 2.2

Aktivitetet për objektiven e dytë për vitet 2025-2027:

2.1 Krijimi i rrjetit të resurseve, duke përfshirë resurse të specializuara për përmirësimin e ofrimit të ndihmës juridike falas.

Organizimi i tryezave dhe punëtorive me përfaqësues të institucioneve të cilat në mënyrë direkte apo indirekte janë të lidhura me punën e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas.

Andaj vlera e kërkuar për mjete shtesë për Organizimin e javës së ndihmës juridike për periudhën 2025-2027 në total është 15,000.00 €.

2.2 Fushatat vetëdijësuese

Duke e ditur gjendjen aktuale dhe nevojën për rritjen e vetëdijësimit të qytetarëve, ANJF planifikon organizimin e fushatave vetëdijësuese me qëllim të informimit të qytetarëve për të drejtat e tyre të garantuara me ligj dhe për shërbimet të cilat ofrohen nga ANJF.

Si aktivitet i fushatës vetëdijësuese hyjnë shtypja dhe shpërndarja e materialit promovues, broshurave, posterave, fletëpalosjeve, realizimit të spoteve informuese. Për realizimin e aktiviteteve rreth vetëdijësimit të qytetarëve, ANJF nuk ka të ndara mjete buxhetore, andaj me ndërprerjen e përkrahjes nga donatorët, qytetarët do mbesin në pamundësi, për tu informuar për të drejtat e tyre në shërbimet që ofron ANJF.

Vlera e kërkuar për këtë aktivitet është 15,000.00 € për periudhën 2025-2027.

3. Sigurimi i resurseve të nevojshme njerëzore dhe financiare për të përmbushur obligimet ligjore të ANJF-së

Plani Strategjik i ANJF-së 2021-2025, ndër qëllimet strategjike ka sigurimin e resurseve financiare për të përmbushur obligimet ligjore të ANJF-së dhe rritjen e efikasitetit administrativ dhe financiar. Financimi është mjet i nevojshëm për çdo organizatë për të implementuar në mënyrë efektive mandatin dhe funksionin e saj. Sigurimi i resurseve të qëndrueshme dhe të mjaftueshme për ANJF është një ndër elementet kryesore, për ti mundësuar dhe plotësuar nevojat e përfituesve potencial të ndihmës juridike falas.

Aktivitetet e objektives së tretë për vitin 2025

3.1 Shqyrtimi i funksioneve të mbrendshme administrative për të përcaktuar ngritjen e efikasitetit dhe plotësimin e pozitave të punës në pajtim me legjislacionin në fuqi, si: Ligjin Nr. 03/L-048 për Menaxhimin Financave Publike dhe Përgjegjësitë, dhe nevojat e paraqitura në institucion për vitin 2025.

Zyra e Drejtorit Ekzekutiv:

- Zyrtar i lartë ekzekutiv 1 (një)
- Zyrtar i lartë çertifikues 1 (një),
- Zyrtar i lartë për burime njerzore 1 (një),

Vlera vjetore e kërkuar për këto pozita shtesë është 24,300.00 €.

Departamenti për Financa dhe divizioni Shërbime të Përgjithshme të Agjencisë kërkon këto pozita shtesë dhe mjete shtesë për:

- Udhëheqës divizioni 1 (një) pozita
- Zyrtar për logjistik 1 (një),

Vlera vjetore e kërkuar për këto pozita shtesë është 17,200.00 €.

Me qëllim të përmbushjes së objektivës së parë, sigurimit të shtrirjes së ndihmës juridike falas në tërë territorin e Republikës së Kosovës, si dhe mirëfunksionalizimit të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas, për përmbushjen e obligimeve që rrjedhin nga Ligji nr 04/L-017 për Ndihmë Juridike Falas, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr 08/L-035, kërkojmë riklasifikim të pozitive ekzistuese dhe sigurimin e buxhetit të nevojshëm për mbulimin e pagave për zyrtarët duke i klafisikuar nga professional 3 në professional 2, perkateësisht nga niveli professional 2 ne nivelin professional 1. Në vazhdim paraqesim numrin e zyrtarëve për riklasifikim si dhe mjetet shtesë të nevojshme:

- Zyrtar IT-së riklasifikim
- Zyrtar i lartë për zotime
- Zyrtar i lartë për shpenzime.

Vlera e pagave për nivelizim, saktësisht diferenca për nivelizim është 3,360.00 €.

3.2 Inkorporimi i nevojave për trajnime në vlerësimin e performances së personelit në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtar për të përcaktuar programet e trajnimeve të përshtatura me buxhetin e Agjencisë për periudhën 2025-2027.

Ofrimi i shërbimeve cilësore për qytetarët, konsiston në ndërtimin e një institucioni efektiv që nënkupton ofrimin e ndihmës juridike falas, duke u bazuar në ndërtimin e një administrate profesionale dhe efikase, sipas standardeve Evropiane.

Programi i trajnimeve për ndërtimin e kapaciteteve profesionale në ANJF nënkupton dhënien e kontributit të rëndësishëm në zhvillimin dhe ndërtimin e kapaciteteve të ANJF, për të siguruar efektivitet dhe marrje përsipër të përgjegjësi dhe kompetencave në institucionin e ndihmës juridike falas. Meqenëse ANJF ofron shërbime juridike falas në lëmin civile, administrative, penale dhe kundërvajtëse dhe bazuar në llojllojshmërinë e rasteve, të cilat deri më tani janë trajtuar, konsiderohen si nevojë e domosdoshme trajnimet profesionale.

Buxheti i ANJF është i limituar për këtë fushë karrshi nevojave për trajnime. Kryesisht trajnimet profesionale për stafin e ANJF-së janë mbështetur nga donatorët.

Trajnimet vlerësohen me kosto në vlerë prej 2,300.00 € për një trajnim dhe synohen të mbahen 6 trajnime të tilla.

Vlera vjetore e kërkuar për këtë aktivitet është 13,800.00 €.

3.3 Takimet për fuqizim operacional për periudhën 2025-2027

Ndërtim i vazhdueshëm i kapaciteteve institucionale të personelit të Agjencisë, që janë të përfshirë në ofrimin e ndihmës juridike falas. Përditësimi si dhe/ose krijimi, si dhe zbatimi i rregullt dhe uniformi i procedurave operative në fushat e ndryshme që kanë të bëjnë me dispozitat për ofrimin e shërbimeve juridike falas. Puna me zyrat rajonale dhe mobile të Agjencisë dhe subjektet e tjerë vendorë dhe ndërkombëtarë për të krijuar, rishikuar, dhe sipas nevojës për të përditësuar procedurat standarde operative dhe praktikat më të mira që kanë të bëjnë me funksionet e ndryshme organizative.

ANJF momentalisht, ka shtrirje në 21 komuna të Republikës së Kosovës dhe është në proces të edhe 9 (nëntë) zyre mobile të tjera, ku në vitin 2024 parashihet të mbuloj 30 komuna. Takimet e rregullta të stafit janë të rëndësishme për fuqizimin operacional të ANJF-së. Në të kaluarën, këto takime janë mbështetur financiarisht nga USAID "Programi Drejtësia Vlenë". Mirëpo, ne si institucion kemi nevojë që të sigurojme qëndrueshmërinë buxhetore për mbajtjen e këtyre takimeve, ndryshe në bazë të buxhetit të tanishëm nuk do të mund të mbahen takimet e rregullta periodike të stafit.

Kërkojmë që të mbështetet ANJF-ja në organizimin e takimeve periodike për vitin 2024 dhe vitet në vijim, ku parashihet të mbahen 4 (katër) takime të rregullta vjetore.

Takimet vlerësohen me kosto në vlerë prej 600.00 € për takim dhe synohen të mbahen 4 takime të tilla. **Vlera vjetore e kërkuar për këtë aktivitet është 2,400.00 €.**

4. Vlerësimi dhe përmirësimi i kornizës legislative që rregullon punën e Agjencisë

Qëllim tjetër strategjik i ANJF-së, është edhe marrja e hapave të nevojshëm për përmirësimin e kornizës ligjore që rregullon ndihmën juridike falas.

Korniza legislative aktuale që rregullon dispozitat lidhur me ndihmën juridike falas, duhet të rishikohet, për të siguruar që autoritetet përkatëse brenda mandatit të tyre të mund ta zbatojnë atë në mënyrë më efektive. Në vitin 2023 ANJF dorëzon koncept dokumentin për ANJF-në, i cili pritet të miratohet në vitin 2024, dhe si rrjedhojë ANJF duhet t'i rishikojë rregulloret e mbrendshme ekzistuese për t'u siguruar se janë hartuar të gjitha rregulloret e nevojshme.

Aktiviteti i nevojshëm për këtë objektiv është:

4.1 Themelimi i grupit punues brenda Agjencisë

Themelimi i grupit punues, brenda Agjencisë, i përbërë nga personeli i menaxhmentit dhe zyrave rajonale për ndihmë juridike falas, që do të kenë për detyrë hartimin e akteve të reja nënligjore të domosdoshme për Agjencinë. ANJF llogaritë që të ketë 3 grupe punuese gjatë vitit me një kosto prej 2,000.00 €/grupi punues. **Kostoja totale vjetore 6,000.00 €.**

1. Trendet e financimit 2023-2024 dhe vlerësimet 2025-2027

Tabela 1: Trendet e financimit 2023-2024 dhe vlerësimet 2025-2027

| Agjencia per Ndhme Juridike Falas | 2023 Buxheti i shpenzuar | 2024 buxhetuar | 2025 vleresuar | 2026 vleresuar | 2027 vleresuar |
|-----------------------------------|--------------------------|----------------|----------------|----------------|----------------|
| Total | | | | | |
| Nr i punetoreve | 36 | 41 | 41 | 41 | 41 |
| Pagat dhe medijtjet | 236,280.00 | 307,831.00 | 307,831.00 | 307,831.00 | 307,831.00 |
| Mallra dhe Sherbime | 178,332.45 | 220,000.00 | 220,000.00 | 220,000.00 | 220,000.00 |
| Sherbime Komunale | 6,258.26 | 10,000.00 | 10,000.00 | 10,000.00 | 10,000.00 |
| Subvencione dhe Transfere | | | | | |
| Shpenzime kapitale | | | | | |
| Burimet e financimit | | | | | |
| Grantet Qeveritare | 420,870.71 | 537,831.00 | 537,831.00 | 537,831.00 | 537,831.00 |
| Te hyrat vetanake | | | | | |
| Financimet nga huamarrjet | | | | | |
| Grantet nga Donatoret | | | | | |
| | | | | | |

Tabela 2. Propozimet për politika të reja të organizatës buxhetore

Planifikimi për vitin 2025

| Politika e re prioritare 1. | viti 2025 vleresuar sipas Ligjit te ri per paga nr 08/L-196 | viti 2025 Kërkesa | Totali i vitit 2025 |
|---|---|-------------------|---------------------|
| Pershkrimi | | | |
| Nderlidhja e politikës se re me Deklaratën e Prioriteteve Afatmesme 2025-2027 | | | |
| Nr i punetoreve te rinj | 41 | 16 | 57 |
| Nr i punëtorëve per riklasifikim | | 31 | |
| Pagat dhe medijtjet | 307,831.00 | 179,160.00 | 486,991.00 |
| Mallra dhe sherbime | 220,000.00 | 45,700.00 | 265,700.00 |
| Sherbime komunale | 10,000.00 | | 10,000.00 |
| Subvencione dhe transfere | | | - |
| Shpenzime kapitale | | | - |
| Burimet e financimit | | | - |
| Grantet Qeveritare | 537,831.00 | 224,860.00 | 762,691.00 |
| Te hyrat vetanake | | | |
| Financimet nga huamarjet | | | |
| Grantet nga Donatoret | | | |

Kërkesa për mjete shtesë për vitin 2025 dhe vlerësimet për vitet 2026-2027

| Politika e re prioritare 1. | viti 2025 Kërkesa | viti 2026 Kërkesa | Totali për vitin 2026 | viti 2027 Kërkesa | Totali për vitin 2027 |
|---|--|-------------------|-----------------------|-------------------|-----------------------|
| Pershkrimi | Përbushja e Ligjit për Ndihmë Juridike Falas dhe mirëfunksionalizimi | | | | |
| Nderlidhja e politikës se re me Deklaratën e Prioriteteve Afatmesme 2025-2027 | | | | | |
| Nr i punetoreve te rinj | 16 | 0 | | | |
| Nr i punëtorëve per riklasifikim | 31 | | | | |
| Pagat dhe medijtjet | 486,991.00 | | 511,331.00 | | 536,897.55 |
| Mallra dhe sherbime | 265,700.00 | 45,700.00 | 265,700.00 | 45,700.00 | 265,700.00 |
| Sherbime komunale | 10,000.00 | | 10,000.00 | | 10,000.00 |
| Subvencione dhe transfere | | | | | |
| Shpenzime kapitale | | | | | |
| Burimet e financimit | | | | | |
| Grantet Qeveritare | 762,691.00 | 45,700.00 | 787,031.00 | 45,700.00 | 812,597.55 |
| Te hyrat vetanake | | | | | |
| Financimet nga huamarjet | | | | | |
| Grantet nga Donatoret | | | | | |

Sa i përket të dhënave në tabelën 2 (dy), deri në vitin 2025 janë kalkuluar 16 pozita të reja, të cilat janë:

- Drejtor Departamenti 1(një) pozitë,
- Udhëheqës divizioni 9 (nëntë) pozita
- Zyrtar i Lartë Ligjor 2(dy) pozita
- Zyrtar i Lartë ekzekutiv 1(një) pozitë,
- Zyrtar i Lartë Certifikues 1(një) pozitë,
- Zyrtar i Lartë i Burimeve Njerëzore 1(një) pozitë,
- Zyrtar për logjistik 1 (një) pozitë,
- Shpenzimet për shërbimet e përfaqësimit dhe avokaturës,
- Shpenzimet për fushata vetëdijësuese,
- Shpenzimet mirëmbajtjen e platformës online,
- Shpenzimet për punëtorë dhe trajnime në ngritjen profesionale të zyrtarëve.
- Shpenzimet për grupe punuese.

Treguesit kyq të performancës që përshkruajnë rezultatet e pritura të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas për vitet 2024-2026

| viti | Buxheti total i shërbimit/subvencionit | Numri total i përfituesve | Numri i përfituesve gra | Numri i përfituesve burra | Buxheti për gra | Buxheti për burra |
|------------------|--|---------------------------|-------------------------|---------------------------|-----------------|-------------------|
| Planifikimi 2024 | 126,000.00 | 6,150 | 2,952 | 3,198 | 58,515.3 | 67,484.7 |
| Planifikimi 2025 | 130,000.00 | 6,400 | 3,120 | 3,280 | 62,000.00 | 68,000.00 |
| Planifikimi 2026 | 150,000.00 | 6,600 | 3,250 | 3,350 | 120,000.00 | 130,000.00 |

Ju faleminderit për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

Me respekt,